



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:281553
Datë: 30.09.2020
Numri i dokumentit: 01153075

C.nr.1015/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni Civil, Gjyqtari Ahmet Idrizaj, me zyrtaren ligjore Albana Curri, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit A. H. nga Gjakova, të cilin e përfaqëson i autorizuari Korab Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e ushqimit - shujtave për ditët e pranisë në punë, vlera e kontestit 2,242.00€, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 08.09.2020, në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të të paditurës, me datë 30.09.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit A. H. nga Gjakova, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të ushqimit – shujtave për ditët e pranisë në punë (për periudhën kohore 01.01.2015 e deri me datë 29.02.2020, respektivisht 1121 ditë pune të realizuara), të ia paguajë shumën prej 2,242.00€ (pra për çdo ditë pune të realizuar të ia paguajë shumën nga 2€), me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit 08.09.2020 e tutje, deri në pagimin definitiv, si dhe në emër të shpenzimeve procedurale shumën prej 404,40€, (ndërsa shuma e mbetur e shpenzimeve në lartësi prej 104,00€, iu refuzua si e pathemeltë), e gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Paditësi në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor në këtë çështje juridike, nëpërmes të autorizuarit të lartpërmendur të tij, ka parashtruar se i njëjti është punësuar në Gjimnazin “H. D.” në Gjakovë, në cilësinë e “Profesor i Edukatës Fizike”, me normën e plotë prej 40 orëve. Të njëjtit në bazë të nenit 36 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar, e nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe SBASHK, me datë 11.04.2014 dhe në bazë të nenit 35, par. 7 të Kontratës Kolektive, e nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe SBASHK, me datë 18.04.2014, i takojnë nga dy (2) € ditë për çdo ditë të paraqitur në punë, në emër të ushqimit – shujtës, e të cilin obligim duhet të e kryejë e paditura e cila ka legjitimitet të plotë pasiv. E paditura edhe përkundër detyrimeve të cilat rrjedhin nga Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës dhe Kontrata Kolektive, nuk ka përmbushur obligimet e caktuara që rrjedhin nga të njëjtat, kështu që për këtë arsye paditësi ka qenë e detyruar që të parashtojë padi – kërkesëpadi dhe të kërkojë realizimin e të drejtës së tij subjektive.

I autorizuari i paditësit në fjalën përfundimtare deklarojë se nga provat e administruara, vërtetohet se kërkesëpadia e precizuar e paditësit është në tërësi e themeltë dhe gjykatës i propozojë që të njëjtën si të këtillë të e miratojë. Më tej shtoj se lartësia e kërkesëpadi së precizuar, argumentohet në

Vërtetimin e lëshuar nga Administrata e Gjinnazit “H. D.” në Gjakovë dhe i cili vërtetim është lëshuar për periudhën kohore kur kanë hyrë në fuqi kontratat kolektive (e vitit 2015 dhe 2017), për periudhën prej 01.01.2015 - 29.02.2020, ashtu që nga kjo provë vërtetohet se paditësi ka punuar gjithsejtë 1121 ditë pune x 2€= me vlerën e kërkesëpadisë, përkatësisht shumën prej 2,242.00€, me çka vërtetohet edhe lartësia e kërkesëpadisë. Nga vërtetimi tjetër nr. 3479, i lëshuar me datë 27.11.2019, i lëshuar nga Gjinnazi “H. D.” në Gjakovë, vërtetohet se paditësi ka punuar dhe vazhdon të punojë në institucionin e lartpërmendur në cilësinë e profesorit të edukatës fizike. Ky fakt vërtetohet edhe nga kontrata e punës, e cila është zbatuar në cilësi të provës.

Shpenzimet procedurale i kërkojë dhe atë për pagesën e taksës gjyqësore për padi, në lartësinë prej 30,00€, për përpilimin e padisë vlerën prej 104,00€, për parashtrësën e datës e dt. 14.07.2020, vlerën prej 104,00€, dhe për pjesëmarrje në dy shqyrtime vlerën nga 135,20€, për secilën seancë (270,40€ për dy seanca), që përfshin shumën e përgjithshme prej 508,40€.

Gjykata ia ka proceduar këtu të paditurës aktvendimin e datës 13.02.2020 (*për dhënien e përgjigjes së detyrueshme në padi*), padinë dhe provat materiale, të cilat e njëjta i ka pranuar me datë 21.02.2020 (siç vërtetohet nga fletë kthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës), mirëpo përgjigjen në padi e ka parashtruar me datë 20.05.2020, d.m.th pas afro tre muajve, përkatësisht pas kalimit të afatit të paraparë ligjor, ashtu siç ka qenë e detyruar në aktvendimin e lartcekur.

Gjykata me propozimin e të autorizuarit të palës aktive në procedurë dhe në kuptim të nenit 423 par. 4 i LPK-së, shqyrtimin kryesor e mbajti në mungesë të paditurës së ftuar në mënyrë të rregullt, me ç’rast pas analizimit të fakteve juridike relevante të kësaj çështjeje, vlerësimi veç e veç të provave dhe lidhshmërinë e tyre reciproke, e në kuptim të nenit 8 të LPK-së, vërtetojë se kërkesëpadia e precizuar e paditësit, është në tërësi e themeltë dhe si e tillë, u aprovua.

Nga provat e zbatuara, rezultojë gjendja faktike si në vijim:

Nga Vërtetimi nr. 3998, i datës 09.07.2020, i lëshuar nga Gjinnazi “H. D.” në Gjakovë, vërtetohet se paditësi nga data 01.01.2015 e deri në vitin shkollor 2019-2020, ka qenë në vendin e punës për 1121 ditë punë.

Nga Kontratë pune, e lëshuar me datë 01.09.2015 nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjakovë, vërtetohet se paditësi është pranuar me kontratë të përhershme të punës me kualifikimin: “Master i kulturës fizike dhe sportit” në lëndën Profesor i edukatës fizike, me orar të plotë pune, dyzet (40) orë në javë. Për më tepër paditësi ka qenë në marrëdhënie pune edhe para vitit 2015, në të njëjtin institucion të arsimit, siç vërtetohet nga kontrata tjetër e datës 24.04.2014, e lidhur në mes të këtu paditësit në cilësinë e punëkryesit dhe të punëdhënësit – të paditurës në rastin konkret DKA.

Nga Vërtetim nr. 3479, i lëshuar me datë 27.11.2019 nga Gjinnazi “H. D.” në Gjakovë, vërtetohet se këtu paditësi është në marrëdhënie të rregullt pune në institucionin e lartpërmendur, prej datës 01.09.1986 e tutje, në vendin e punës : Profesor i edukatës fizike, pra deri më tani i njëjti ka 32 vjet përvojë pune.

Andaj, gjykata në rastin konkret vërteton se në bazë të nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sipas të cilës dispozitë ligjore në mënyrë decisive është paraparë se: “*Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) € për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim, për t’a bërë kompensimin*”. Andaj, meqë pala pasive në procedurë nuk ka argumentuar me prova materiale, e as në përgjigje në padi (të cilën e ka ushtruar pas afatit të paraparë ligjor), nuk ka argumentuar faktin se

e ka të rregulluar çështjen e ushqimit të të punësuarve (në vend punimin – objektin ku ka punuar këtu pala aktive në procedurë) dhe duke pasur parasysh faktin se nga vërtetimi i lart cituar, për periudhën kohore të kërkuar nga pala aktive në procedurë, rezulton se e njëjti ka qenë në vendin e punës për 1121 ditë të punës (x 2€ në ditë) dhe për këtë arsye kërkesëpadia e tij e precizuar në lartësi prej 2,242.00€, është e themeltë dhe si të këtillë, gjykata e aprovojë.

Gjykata vlerëson se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, është në fuqi dhe e zbatueshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe se ky dokument kontraktual, prodhon efekt juridik ndaj palëve në procedurë të cilat janë të legjitimuara në kuptimin e legjitimitetit real aktiv dhe pasiv në këtë çështje juridike.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar sipas nenit 452 par. 1 të LPK-së, me ç’rast paditësi për udhëheqjen e kësaj procedurë ka pasur shpenzime të domosdoshme, siç më poshtë vijnë: në emër të taksës gjyqësore të paguar për padi, shuma prej 30,00€, për përpilimin e padisë, shumën prej 104,00€, për pjesëmarrje në dy shqyrtime, shumën prej 270,40€, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 404,40€, ndërsa nuk ia pranojë shumën tjetër të kërkuar prej 104,00€, e cila shumë i referohet përpilimit të parashtresës së datës 22.07.2020, meqë përmbajtjen e të njëjës parashtresë i autorizuari i palës aktive në procedurë ka mundur që të i paraqesë në shqyrtim, ashtu që kërkesa e të njëjtit, bie ndesh me nenin 2 par. 1, të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit (datë 23.03.2019), sipas të cilës dispozitë është paraparë se *“Avokati nuk duhet t’i shkaktojë palës shpenzime të panevojshme”*, si dhe me nenin 4 të LMD-së, i cili parasheh se: *“Në krijimin e marrëdhënieve të detyrimeve dhe në ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga këto marrëdhënie, pjesëmarrësit duhet t’i përmbahen parimit të ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë”*.

Nga te lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
C.nr.1015/2019, datë 30.09.2020

GJYQTARI,
Ahmet Idrizaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.